



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. 5022 Prot

Vau Dejës, më 22. 08. 2023

Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimin për *“Miratimin e ndryshimit të nivelit të pagave për policinë bashkiake të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023”* për Bashkinë Vau Dejës”

Duke ju uruar punë të mbarë!

KRYETAR

Kristian SHKRELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KRYETAR

Nr. ____ Prot

Vau Dejës, më ____ . ____ .2023

PROJEKT VENDIM

Nr. 07, datë 22.08.2023

PËR

**“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NIVELIT TË PAGAVE PËR POLICINË
BASHKIAKE TË BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2023”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja “ç”, dhe nenit 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të ligjit nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligji 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’ të ndryshuar; ligji nr 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” neni 28, pika 1; VKM nr 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës bazë minimale në shkallë vendi”; VKM nr 328 datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, sipas VKB nr 84 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Vau Dejës, dhe me shkresë nr 24/1 dt 12.01.2023 të miratuar nga Prefektura Shkodër dhe sipas relacionit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë:

V E N D O S A:

1. Miratimin e nivelit të pagave për policinë bashkiake të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023 si me poshtë vijon:
 - Niveli i pagave për policinë bashkiake ndryshohet sipas lidhjes 1.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.


3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETAR


Kristian SHKRELI




Drejtoria e Burimeve Njerëzore



*Drejtoria Juridike e Integritit Prokurimeve
dhe Aseteve*



*Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit
Financiar*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

RELACION

PËR

**“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NIVELIT TË PAGAVE PËR POLICINË
BASHKIAKE TË BASHKISË VAU DEJËS PËR VITIN 2023”**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Vau Dejës, për efekt të zbatimit të akteve ligjore të ndryshuara në lidhje me nivelin e pagave për punonjësit e policisë bashkiake, paraqet këtë relacion me ndryshimet si më poshtë:

VKM nr.113 dt.01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi bëhet 40 000 (dyzet mijë) lekë nga 34 000 (tridhjetë e katër mijë) lekë që ishte.

VKM nr. 328, date 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufij vetë pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Ligji nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”, neni 28, pika 1 dhe neni 52 i këtij ligji.

Kryeinspektori i Policisë Bashkiake të paguhet sipas kategorisë III-a/1.

Inspektori të paguhet sipas kategorisë III-b.

Polici Bashkiak të paguhet sipas kategorisë IV-a.

Nga sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projekt vendimi në zbatim të vendimeve të mësipërme.

SE
ASHK



Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e këtij projekt vendimi.

Konceptoi:

S/BNJ

Snezhana Gjonaj

Miratoi:

D/BNJ

Xhuana Kaci

KRYETARI

Kristian Shkreli